



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 39, datë 23.10.2024

PËR

NJË SHITESË NË METODOLOGJINË DHE PROCEDURËN PËR MIRATIMIN E
TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UJËSJELLËS KANALIZIME

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (*ligji nr. 8102*),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 23.10.2024 pasi diskutoi informacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe Konsumatorit mbi disa ndryshime në metodologjinë dhe procedurën për miratimin e tarifave të shërbimeve të Ujësjiellës Kanalizimeve të miratuar nga KKRR me vendimin nr. 539, datë 30.12.2021

Konstatohet se:

1. Referuar VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", u parashikua që sektori UK të riorganizohet në 15 shoqëri UK Rajonale nga 58 shoqëri UK. Aktualisht janë krijuar dhe operojnë në sektor 14 shoqëri rajonale UK dhe 3 shoqëri UK ekzistuese.
2. Në nenin 6 "Politika e ndër financimit midis klientëve" të Metodologjisë dhe Procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjiellës kanalizimeve, citohet se shoqëritë mund të propozojnë tarifa të diferencuara ndërmjet kategorive të ndryshme të klientëve, përkatësisht ndërmjet atyre familjarë dhe publikë e privatë (kategoritë "a", "b" dhe "c"), por me tendencë rregullimin gradual të ndërfinancimit të tyre, me qëllim që raporti maksimal ndërmjet tarifave të klientëve publikë e privatë me ata familjarë nuk duhet të jetë më i madh se dy (2).
3. Gjatë analizës tekniko ekonomike të aplikimeve për nivel të ri tarifor, referuar dhe riorganizimit të shoqërive UK, është konstatuar se ka diferenca midis tarifave ekzistuese të klientëve familjare me klientët jo familjarë (publik dhe privat), duke e bërë të pamundur respektimin e koeficientit tarifor të përcaktuar në nenin 6 "Politika e ndër financimit midis klientëve" gjatë propozimit për nivel të ri tarifor.

4. Nisur nga riorganizimi i sektorit dhe studimit të kryer mbi tarifatat ekzistuese që aplikohen aktualisht, pritet që edhe shoqëri të tjera UK Rajonale të cilat do të aplikojnë për nivel të ri tarifor të paraqesin të njëjtën problematikë sa i përket diferencave më shumë se dy ndërmjet klientëve familjare dhe jo familjare (publik dhe privat).

Komisioni Kombëtar Rregullator duke patur parasysh situatën aktuale të riorganizimit në sektorin UK si dhe duke marrë në konsideratë faktin se vendimi nr. 539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve" është miratuar përpara fillimit të reformës në sektorin UK, vlerësoi nevojën për rishikimin e pikës 1 të nenit 6 të metodologjisë së tarifave.

Për gjithë sa më sipër në zbatim të nenit 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e nenit 6 "Politika e Ndër financimit midis Klientëve" të Metodologjisë dhe Procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjellës kanalizime bëhet si më poshtë:

1. a) *Shoqëritë mund të propozojnë tarifa të diferencuara ndërmjet kategorive të ndryshme të klientëve, përkatësisht ndërmjet atyre familjarë dhe publikë e privatë (kategoritë "a", "b" dhe "c"), por me tendencë rregullimin gradual të ndërfinancimit të tyre, me qëllim që raporti maksimal ndërmjet tarifave të klientëve publikë e privatë me ata familjarë nuk duhet të jetë më i madh se dy (2).*

1. b) *Politika e parashikuar në pikën 1. a) nuk do të jetë detyruese në rastet kur tarifatat ekzistuese të aplikuar nga shoqëritë Ujësjellës Kanalizime në raport me tarifatat e propozuara nga shoqëritë UK ndërmjet kategorive të klientëve familjar me ato jo familjar (publik, privat) nuk respektojnë koeficientin 2 (dy).*

Ky vendim hyn në fuqi me menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE
Evis Shurdha